



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGI ELEKTRIKE SH.A.  
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVAJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

**KEDS - SH.A.**

Ndërtesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr.3  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building  
Bill Clinton Boulevard no.3  
Prishtina 10 000  
Republic of Kosovo



Nr. 04 Dt. 21.01.2020  
HQ 1

Arsim Janova  
u.d. Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Alper Erbas  
Drejtor Menaxhues, KEDS sh.a

21 Janar 2020

**LËNDA: PROPOZIM PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE PËR VITIN TARIFOR 2020**

I nderuari z. Janova,

Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale është përgatitur nga KEDS në formë elektronike dhe në letër, duke respektuar afatin kohorë të përcaktuar në shtojcën 7 të Rregullës mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së) dhe udhëzimeve të ZRRE-së dhënë në shkresën e datës 9 dhjetor 2019.

KEDS mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përshtatshme të cilat janë në interesin e të gjitha palëve pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

Sinqerisht

Alper Erbas  
Drejtor Menaxhues, KEDS Sh.a



Ndërtesa e Elektrokovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    *Bill Clinton Bulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



# **Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale në vitin 2020 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes**

---

**Janar 2020**



## Përmbajtja:

1. Hyrje .....	3
2. Bilanci i energjisë elektrike .....	4
3. Kostoja e Humbjeve .....	6
3.1. Përcaktimi i caktut të humbjeve për periudhën e dytë rregullative .....	6
3.2. Kostoja e humbjeve në vitin përkatës t .....	7
3.3. Përshtatjet e kostos së humbjeve për vitin përkatës t-1 .....	8
4. Kostot operative.....	10
5. Kostot e Investimeve Kapitale .....	14
6. Kostot e tjera.....	16
6.1. Detyrimi për Operatorin e Sistemit të Transmisionit.....	16
6.2. Të Hyrat e parregulluara dhe të Hyrat e përjashtuara.....	17
7. Faktori i Rregullimit të të Ardhurave – KREV .....	18
8. Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për vitin përkatës t.....	19



## 1. Hyrje

KEDS i licencuar si Operator i Sistemit të Shpërndarjes ka përgatitur kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për vitin 2020, në përputhje me Shtojcën 7 të Rregullës për të Hyrat e lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së), dhe letrës zyrtare të ZRRE-së të pranuar më 9 dhjetor 2019.

Në përputhje me rregullën për vendosjen e të hyrave të OSSH-së, ky aplikim përfshin të dhënat sipas komponentëve të formulës për përshtatje të rregullt, përfshirë të gjitha arsyetimet e nevojshme lidhur me shpenzimet e arsyeshme, të cilat mundësojnë operimin e qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve për të gjithë konsumatorët e tij.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka përditësuar të dhënat e aprovuara gjatë procesit shumëvjeçar të vendosjes së të hyrave të lejuara maksimale, në pajtim me rregullën për të hyrat e OSSH-së, respektivisht për shkak të ndryshimeve që ndodhin ndërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Duke qenë se procesi tarifor është interaktiv ndërmjet ZRRE-së dhe të licencuarve të tjerë, si dhe për shkak të ndryshimeve në legjislacion, ky aplikacion mund të përshtatet tutje me qëllim të reflektimit të kostove që janë të ndërlidhura me të licencuarit e tjerë.

Struktura e dokumentit përbëhet nga tetë pjesë kryesore, përkatësisht:

1. Bilanci i energjisë elektrike
2. Kostot operative
3. Kostot e investimeve kapitale
4. Kostot e humbjeve
5. Kostot tjera
6. Faktori Korrigjues - KREV
7. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant t.

OSSH mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim të arritjes së konkluzioneve të duhura, të cilat janë në interes të të gjithë akterëve të përfshirë në sektorin e energjisë.



## 2. Bilanci i energjisë elektrike

Parashikimi i Bilancit të energjisë elektrike për qëllime të operatorit të sistemit të shpërndarjes është bërë sipas parashikimit të konsumit nga furnizuesit dhe humbjeve reale të pritshme. Në koordinim me furnizuesit e licencuar dhe aktiv, OSSH ka paraparë 4,151 GWh konsum në nivelin e shpërndarjes për vitin 2020, me një shpërndarje ndërmjet grupeve tarifore si më poshtë:

Konsumatorët	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhje	Tot
Kons. e kyçur në nivel 35 kV	4	4	5	5	4	5	5	5	5	5	5	6	58
Kons. e kyçur në nivel 10 kV	39	35	39	34	31	33	35	36	34	37	41	49	442
Kons. Komerical 0.4 kV	38	31	37	29	31	30	34	35	30	32	35	41	403
Kons. Komerical 0.4/II kV	67	57	58	46	47	45	50	55	48	48	56	68	645
Amvisnia	287	231	241	195	197	180	188	194	180	195	219	268	2,574
Ndriçimi publik	3	3	3	2	2	2	2	2	2	3	3	3	29
<b>Konsumi në nivel të shpër.</b>	<b>438</b>	<b>361</b>	<b>383</b>	<b>310</b>	<b>312</b>	<b>294</b>	<b>315</b>	<b>327</b>	<b>298</b>	<b>319</b>	<b>359</b>	<b>435</b>	<b>4,151</b>

Shitjet e parashikuara për vitin 2020 paraqesin një rritje prej 6 % krahasuar me konsumin aktual të realizuar gjatë vitit 2019. Niveli i rritur i konsumit është në përputhje me nivelin aktual të rritjes së konsumit në baza vjetore që nga ndryshimi i strukturës tarifore (2017), si dhe rritjes së konsumit ndërmjet vlerave të parashikuara dhe atyre të realizuara për çdo vit përkatës.

Konform shitjeve të pritura për vitin 2020, OSSH ka parashikuar edhe humbjet në shpërndarje për vitin 2020, në bazë të nivelit të arsyeshëm që mund të pritët dhe në linjë me parashikimin e shitjeve për vitin 2020. Konform Bilancit të energjisë për vitin 2020, OSSH i ka paraqitur humbjet në dy linja: a) humbjet e lejuara - sipas vendimit të ZRRE V\_1019\_2018 të datës 20 gusht 2018 dhe b) humbjet e tejkaluara - që paraqesin humbjet mbi nivelin e lejuar të humbjeve, e cila siguron se konsumatorët do të jenë të ngarkuar vetëm me nivelin e lejuar të humbjeve, pasi kjo përbën një kosto të drejtpërdrejtë për kompaninë.



Ndërtesa e Elektrokosovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    *Bill Clinton Boulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



Në këtë kuptim energjia në nivel të shpërndarjes – ENSh (shitje dhe humbje) e paraparë për vitin 2020 është 5,517 GWh, e cila është 4% më e lartë se ENSh e realizuar në vitin 2019, respektivisht konform rritjes së realizuar në dy vitet e fundit. Në bazë të të dhënave historike të viteve të fundit kemi vërejtur një shmangie afërsisht 10 % nga parashikimi dhe realizimi i energjisë në nivel të shpërndarjes (ENSh) për vitin 2017. I njëjti fenomen vërehet edhe në vitin 2018. Kjo ka rezultuar si rrjedhojë e ndryshimeve të strukturës tarifore dhe ndryshimit të sjelljes së konsumatorëve. Ky trend i konsumit është reflektuar në parashikimet për vitin 2020 ku ENSh është parashikuar të rritet 10% në krahasim me vitin 2018, respektivisht 3.7% krahasuar me ENSh-në për vitin 2019.



### 3. Kostoja e Humbjeve

#### 3.1. Përcaktimi i caktut të humbjeve për periudhën e dytë rregullative

Humbjet në shpërndarje dhe kostot e tyre të lejuara rregullohen përmes Rregullës për të hyrat e OSSH-së, përkatësisht nenit 12 të Rregullës.

Më 20 gusht 2018, ZRRE përmes vendimit V\_1019\_2018 ka aprovuar nivelin e lejuar të humbjeve për periudhën e ardhshme rregullative 2018-2022. Pavarësisht mos-pajtimeve ndërmjet ZRRE-së dhe OSSH-së lidhur me përcaktimin e caktut për zvogëlimin e humbjeve në nivel të shpërndarjes, OSSH në këtë aplikim ka përdorur nivelin e lejuar të humbjeve.

Duhet theksuar, se këtë vit, për shkak të projektit të KEK-Gjenerimit në lidhje me njësinë gjeneruese B1, projekt ky i cili do të financohet nga fondet IPA, plani Vjetor i KEK-ut për vitin 2020 përveç planit të rregullt të mirëmbajtjes, parasheh që njësinë gjeneruese B1 të dalë jashtë operimit nga 13 Prilli 2020 deri në fund të vitit. Duke pasur parasysh që Kosova nuk ka prodhim të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e saj për konsum dhe KEK-Gjenerimi përbën 90% të prodhimit vendor, mos-operimi i njësisë gjeneruese B1 po ndikon jashtëzakonisht shumë në nevojën e importit, veçanërisht për blerjen e humbjeve të cilat nuk kanë prioritet në blerjet nga KEK-gjenerimi. Megjithëse nuk është relevante për këtë aplikim, duhet të theksohet se mos-operimi i njësisë së gjenerimit B1 pritet të jetë më i gjatë seç është parashikuar, i përcjell menjëherë nga mos-operimi i njësisë gjeneruese B2, si faza II-të e projektit të IPA-s, duke e ndikuar kështu në varësinë nga importi për një periudhë shumë më të gjatë, e veçanërisht gjatë kohës kur kërkesa për konsum është e lartë.

Kjo përveç që rrit koston e blerjes së humbjeve, rrezikon edhe sigurinë e furnizimit në vend. Mungesa e energjisë së disponueshme me çmime të volitshme në treg, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit, kufizimet e mundshme në rrjet (konxhestionet) dhe efekti në çmimet e importit janë disa nga problemet e mundshme që mund të na presin në vitin e ardhshëm. OSSH në një shkresë



zyrtare e ka ngritur këtë çështje tek institucionet relevante, përfshirë edhe ZRRE-në, për të filluar një diskutim midis palëve të interesuara për të analizuar mundësitë e tejkalimit të ndikimeve të mundshme negative, siç është analizimi i potencialit për t'i aktivizuar të gjitha njësitë gjeneruese në Kosovën A, zvogëlimi i numrit apo kohës së mirëmbajtjeve në njësitë aktive të gjenerimit dhe/ose alternativa të tjera të mundshme. Megjithatë, deri në kohën e aplikimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH-në, nuk është ndërmarrë asgjë konkrete.

Për më tepër, KEK-u paraqiti ofertën e saj të çmimeve vetëm më 17 janar 2020, megjithëse OSSH zyrtarisht ka kërkuar të njëjtën më 19 dhjetor 2019, prandaj duke marrë parasysh pamundësinë për negociim dhe respektivisht arritje të një marrëveshje në mungesë të kohës, OSSH në këtë aplikim ka përdorur çmimin aktual për blerjen e humbjeve. Meqenëse KEK dhe OSSH ende nuk kanë arritur një marrëveshje, marrja për bazë e një çmimi referent, ndryshe nga ai i dakorduar mes KEK-ut dhe OSSH-së, do ta vendoste OSSH-në në një pozicion të pa favorshëm financiar në mes të vitit tarifor, nëse KEK-u nuk pranon të shesë energji sipas çmimit referent.

Në këtë kuptim, në kapitujt në vijim kemi paraqitur kostot e pritshme për blerjen e humbjeve të lejuara.

### 3.2. Kostoja e humbjeve në vitin përkatës t

Sipas nenit 12 të Rregullës për të hyrat e OSSH-së, kostoja e lejuar e humbjeve do të llogaritet duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve i cili përcaktohet gjatë Rishikimeve Periodike.

Sipas Shtojcës 1 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të OSSH-së, kostoja e humbjeve llogaritet në tri pjesë, përkatësisht koston e pritshme të humbjeve për vitin përkatës, duke marrë parasysh çmimin referent të energjisë elektrike me shumicë në treg, përshtatjet për energjinë aktuale që hyn në sistemin e shpërndarjes, dhe shpenzimet aktuale me shumicë duke përdorur humbjet aktuale të ndodhura, siç tregohet në formulën e mëposhtme:

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * RWMP_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$





Kostoja e pritshme e blerjes së humbjeve të lejuara për vitin 2020 (pjesa e parë e formulës) është 53.2 milion €, e cila përbëhet 76% nga importi dhe 24% nga KEK-Gjenerimi.

Siç u shpjegua më lartë, gjatë vitit 2020 Njësia gjeneruese B1 e KEK-ut pritet të jetë jashtë operimit nga 13 prilli deri në fund të vitit, situatë kjo e cila ka rritur varshmërinë ndaj importit dhe respektivisht kostove të larta dhe të paparashikuara të importit përgjatë vitit 2020.

Për më tepër, oferta aktuale e pranuar nga KEK po rrit edhe më tej kostot e blerjes së humbjeve të lejuara për 2%. Duke marrë parasysh tendencën e KEK për rritje të vazhdueshme çmimesh, ne mbesim të brengosur se nuk do të arrijmë në një marrëveshjeje me KEK-un para përcaktimit të MAR-it, me ç'rast çdo ndryshim i çmimit nga ai që ZRRE e konsideron të arsyeshëm, do ta vë OSSH-në në vështirësi financiare. OSSH tashmë mban barrën e humbjeve të tejkaluara, kështu që financimi i sektorit për 1 vit është jashtë çdo mundësie financiare, veçanërisht me kufizimet në marrjen e kredisë për shkak të parametrave të aprovuar për periudhën e dytë rregullative. Në këtë kuptim, OSSH kërkon nga ZRRE të shfrytëzojë të drejtën e tij ligjore për të vendosur ndaj KEK-ut obligim publik lidhur me nivelin e lejuar të humbjeve, meqë OSSH ofron shërbime publike dhe si e tillë të shmang ndikimin në tarifat e konsumatorëve fundor.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, duhet të sqarojmë se ne rezervojmë të drejtën të përshtatim aplikimin tonë sipas çmimit të rënë dakord ndërmjet KEK-gjenerimit dhe OSSH-së, para se të merret vendimi final për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2020.

### **3.3. Përshtatjet e kostos së humbjeve për vitin përkatës t-1**

Pjesa e parë e përshtatjeve të kostos së humbjeve pasqyron dallimin në mes të rrjedhës së lejuar dhe aktuale të energjisë (ENSh) në vitin përkatës t-1 (2019), respektivisht diferencën midis kostos së lejuar të humbjeve dhe kostos aktuale të humbjeve duke përdorur nivelin e lejuar për humbjet, siç tregohet në formulën e mëposhtme

$$(LSSCat - 1 - LSSCft - 1) * (1 + It)$$



Gjatë vitit të kaluar, ZRRE ka përdorur me saktësi vëllimet e energjisë elektrike siç kërkohej nga OSSH, megjithatë energjia që hyn në sistemin e shpërndarjes (ENSh) është llogaritur në bazë të shitjeve të parashikuara dhe nivelit të lejuar të humbjeve, e cila matematikisht është e saktë, megjithatë nuk ka paraqitur një parashikimin real të pritshëm të ENSh-së për vitin 2019. OSSH gjatë fazës së konsultimeve ka komentuar se një qasje e tillë do të rezultojë me përshtatje të mëdha në vitin e ardhshëm, por ZRRE nuk i ka marrë në konsideratë këto komente. Si rezultat i kësaj, përshtatjet për ENSh pa marrë në konsideratë ndryshimet në çmim janë 3 milion €.

Kostoja e humbjeve sipas formulës dhënë në Shtojcën 1 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të OSSH-së përbëhet edhe nga pjesa e tretë e formulës për llogaritjen e humbjeve, e cila parasheh përshtatjet e kostos së lejuar të humbjeve dhe kostos aktuale të humbjeve duke aplikuar faktorin ndarës të humbjeve. Meqë ZRRE nuk ka aplikuar faktorin e ndarjes së humbjeve dhe duke pasur parasysh se në vitet e mëparshme aplikoi këtë të fundit si 0, në mënyrë të ngjashme do të zbatohet edhe në këtë aplikim.



#### 4. Kostot operative

Bazuar në nenin 9 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të OSSH-së, kostot operative dhe të mirëmbajtjes së OSSH-së, që i atribuohen të licencuarit të OSSH-së, mund të mbulohen përmes të Hyrave Maksimale të Lejuara për vitin e ardhshëm relevant.

Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX) për vitin përkatës t përbëhen nga kostot e parashikuara për vitin përkatës t dhe përshtatjet për vitin paraprak t-1, ku përfshihen përshtatjet për inflacion (CPI), efikasitet (E) dhe faktorin e profilizimit (P). Ndërsa pjesa e dytë e përshtatjes së OPEX-it llogaritet si diferencë e kostove të lejuara të OPEX në vitin përkatës t-1 dhe kostove aktuale të shkaktuara në vitin përkatës t-1, të shumëzuara me faktorin e ndarjes.

ZRRE gjatë vitit 2018, përmes shqyrtimit shumëvjeçar ka përcaktuar shpenzimet operative për periudhën 2018-2022, të cilat janë përcaktuar si vazhdimësi e shpenzimeve operative të përcaktuara gjatë periudhës së parë rregullative, por pa ndonjë analizë të detajuar, përderisa OSSH ka argumentuar se shpenzimet janë rritur përgjatë viteve. Në mënyrë të ngjashme edhe numri i shërbimeve dhe cilësia e ofrimit të këtyre shërbimeve ka kosto më të lartë se kostot e lejuara përmes tarifave, siç janë: shpenzimet për TI dhe shpenzimet e telekomunikacionit. Ndryshimet në legjislacion dhe në hapjen e tregut kërkojnë vazhdimisht shërbime të reja, programe më specifike dhe të specializuara të sistemit, por ato nuk janë reflektuar gjatë shqyrtimit shumëvjeçar.

Duhet theksuar se edhe numri i konsumatorëve është vazhdimisht në rritje. Nga 470,000 konsumatorë aktiv në vitin 2013 numri është rritur në mbi 600,000 konsumator aktiv, e cila ka rezultuar edhe me rritjen e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë, por të cilat nuk po reflektohen si të tilla nga Rregullatori. Periudha e parë rregullative ka përfshirë kostot e pagave të punëtorëve të trashëguar nga i licencuari i mëparshëm dhe gjatë kësaj periudhe nuk u lejuan kosto te tjera për punëtorët e rinj. Megjithëse në shqyrtimin e fundit tarifor janë bërë përshtatje, ende qëndrojnë dallime të mëdha në paga në mes OSSH-së dhe sektorit publik,



përderisa volumi i punës është më i lartë, si dhe ambienti i punës shumë më stresues. Kjo mbetet njëra ndër arsyet se shumë punëtorë të kompanisë sonë po migrojnë jashtë vendit, veçanërisht pas hapjes së mundësive për punësim në vendet e ndryshme evropiane. KEDS në vazhdimësi po kërkon të reflektojë pagat e punëtorëve të vet në të njëjtin nivel si operatorët e tjerë në industri të ngjashme, e njëkohësisht do të dëshironte të pasqyroj punën e tyre dhe t'i motivojë punonjësit e vet, nëse kjo lejohet nga rregullatori, prandaj **kërkojmë nga ZRRE të konsiderojë me seriozitet një rritje në linjat e pagave**, e cila duhet të jepet si shtesë ndaj OPEX-it të kërkuar.

Për më tepër, duhet theksuar se kostot e sigurimit shëndetësor të përfshira në Shpenzimet Operative në dy vitet e fundit kanë pësuar rritje mbi 50%. Sektori i energjisë elektrike mbetet ende një punë me rrezik të lartë dhe aksidente të shpeshta në punë. Përkundër faktit se kompania ka investuar shumë në trajnime me qëllim të zvogëlimit të aksidenteve në punë, nevoja për sigurim shëndetësor cilësor është gjithmonë e pranishme. Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të çmimeve të sigurimeve shëndetësore ndër vite, kostot aktuale të lejuara për sigurimin shëndetësor mundësojnë mbulueshmëri minimale. Pranimi i çmimeve aktuale të sigurimeve shëndetësore prej 10 € shtesë për kokë punëtorit ashtu siç po sillen në treg dhe ashtu siç po aplikohen edhe nga të licencuarit e tjerë në sektorin e energjisë, nënkupton një kosto shtesë prej 19,070 € / muaj, e cila kosto do të ishte lehtësi si për kompaninë ashtu edhe për punëtorët duke pasur parasysh që sigurimi shëndetësor jo vetëm që jep siguri në punë, por është gjithashtu kërkesë ligjore. Prandaj, ne kërkojmë nga Rregullatori që të marrë parasysh këto kosto, në përcaktimin e OPEX-it për vitin 2020.

Përveç rritjes së çmimeve në sigurimet shëndetësore, se fundi janë rritur edhe çmimet e sigurimit të automjeteve për 26%, e cila do të ndikoj në rritjen e kostove operative të OSSH-së gjithashtu, respektivisht prej 57,920.4 € në vitin 2019, të njëjtat priten të arrijnë në 72,979.6 €. Në mënyrë të ngjashme, nëse analizojmë shpenzimet e karburantit nga viti 2013 deri në vitin 2019, çmimi i karburantit është rritur mbi baza vjetore, të cilat nuk janë marrë për bazë nga ZRRE në periudhën e parë rregullative, dhe ajo nuk është përshtatur për të pasqyruar çmimet aktuale gjatë



përcaktimit të kostove për periudhën e dytë rregullative. Edhe kostot për mirëmbajtjen e makinerive kane shënuar rritje këtë vit. Pamundësia e blerjes së makinerive të reja, si rezultat i orientimit të investimeve në projektet për arritjen e rezultateve në zvogëlimin e humbjeve, ka rritur dukshëm kërkesën për mirëmbajtjen e veturave . Nga ana tjetër, kostot aktuale të lejuara për mirëmbajtje paraqesin vetëm koston për çmim dhe materiale, pasi shumica e punës bëhet përmes punonjësve të brendshëm, kostot e të cilëve tashmë janë të përfshira në linjat e pagave. Duke pasur parasysh se rrjetin e trashëguar të shpërndarjes e kemi të vjetër dhe të dëmtuar, si dhe shpenzimet e mirëmbajtjes të përdorura në periudhën e parë rregullative në krahasim me nevojat e rrjetit, shtuar edhe ngritjen e çmimeve të materialeve ndër vite, OSSH për periudhën e dytë rregullative sigurisht se ka nevojë për kosto më të larta, e të cilat nuk po përshtaten nga rregullatori për të reflektuar kostot reale të tregut.

Zbatimi i faktorit të efikasitetit në këto kategori po e rëndon gjithnjë e më shumë kompaninë, e cila po përballet me rritje të mëdha të kostove operative, të cilat nuk janë reflektuar si të tilla në shpenzimet operative vjetore dhe për më tepër, OSSH ka ulje të kostove operative të lejuara nga ZRRe-ja për shkak të faktorit të efikasitetit. Ne pajtohemi që përcaktimi i faktorit të efikasitetit rrit performancën e një kompanie, por vetëm atëherë kur kostot aktuale reflektohen me korrektësi. Duhet të theksohet se pagat përbëjnë 80% të totalit të OPEX-it dhe duke pasur parasysh që shumica e kostove të tjera që përbëhen nga OPEX janë përtej kontrollit të OSSH-së, aplikimi i efikasitetit do të ndikojë drejtpërdrejt tek punonjësit dhe tek cilësia e shërbimeve të ofruara. Për më tepër, siç kemi parë nga periudha e parë rregullative, për shkak të mungesës së zhvillimit në ekonominë e vendit në kuptim të gjenerimit të vendeve të reja të punës, çdo ulje e pagës apo ulje e numrit të punëtorëve, ka një ndikim të madh social, dhe si rezultat OSSH mbetet në një pozicion të pafavorshëm financiar, duke u detyruar t'i zvogëlojë kostot në linjat e tjera që janë thelbësore në ofrimin e shërbimeve cilësore, siç janë shërbimet e mirëmbajtjes. Siç jeni informuar, OSSH tashmë ka filluar të zbatojë vendimin e gjykatës i cili kërkon anulimin e vendimit të menaxhmentit për ndërprerjen e kontratave të 80 punonjësve, vendim ky i cili do të rris për



Ndërtesa e Elektrokosovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    *Bill Clinton Bulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



rreth 8% në total nivelin e pagave të përfshira aktualisht në OPEX. Aktualisht këto kosto nuk përfshihen në kërkesën e OSSH-së.

Në të njëjtën kohë, ZRRE gjithashtu duhet të pasqyrojë kostot që pritet të rriten me miratimin e rregullës për standardet e cilësisë së shërbimit, i cili kërkon nga OSSH të plotësojë rezultatet e pritura, prandaj, ne kërkojmë nga ZRRE të pasqyrojë koston reale gjatë përcaktimit të MAR-it përfundimtar për vitin 2020.

OSSH në këtë aplikim ka kërkuar një rritje prej 2% të OPEX-it, e cila siç u tha më lart nuk përfshin koston e rritjes së pagave dhe të punëtoreve të ri-kthyer, por është pasqyrim i rritjes së çmimeve aktuale. Duke marrë parasysh të lartthënat, OSSH në këtë aplikim ka përdorur OPEX prej 26.3 milion € për vitin 2020, duke përfshirë përshtatjet për normën e inflacionit, në përputhje me formulën e përcaktuar në rregull.



## 5. Kostot e Investimeve Kapitale

Plani i Investimeve i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është i dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike me një çmim të arsyeshëm, e njëkohësisht për të siguruar funksionimin e rrjetit në mënyrë transparente dhe në përputhje me parimet komerciale.

Procesi për periudhën e dytë rregullative ka filluar në maj 2017. OSSH bazuar në informatat e njohura në kohën e aplikimit dhe konform planit zhvillimor 10 vjeçar (Master Plan), ka përgatitur planin e saj të investimeve për vitet 2018 - 2022, të cilat janë dorëzuar në ZRRE për aprovim, së bashku me analizën e kosto/përfitim-it (cost-benefit) si kërkesë nga legjislacioni në fuqi. ZRRE-ja konform kësaj kërkesë më 24 shtator 2018 aprovoi investimet kapitale prej 131 milion €, për këtë periudhë rregullative (2018-2022).

Ndryshimet në parametrat rregullativ të aprovuara pas kërkesës së OSSH-së për investimet 2018-2022, sikurse Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC), e miratuar vetëm në fund të gushtit 2018, ka vënë OSSH-në në një situatë financiare jo të favorshme. Rënia e konsiderueshme e WACC-ut të lejuar ka rritur pasigurinë në mesin e institucioneve të kreditimit, duke vënë OSSH-në në një pozitë shumë të pafavorshme financiare. Faktorët e jashtëm, siç janë procedurat burokratike, sfidat operative, vështirësitë e qasjes në pronë, implikimet sociale, krizat ekonomike, etj., ndikojnë gjithashtu si në kosto, ashtu edhe në afatin e realizimit të investimeve të planifikuara.

Marrë parasysh të lart-thënat dhe vonesat në zbatimin e projekteve të parapara për vitin 2018, të cilat rezultuan kryesisht si pasojë e vonesës së aprovimit të Planit të Investimeve nga Rregullatori, OSSH më 4 prill 2019 dorëzoi Planin Vjetor të rishikuar të Investimeve për vitin 2019. Pavarësisht kësaj, OSSH ka tejkalluar parashikimet duke rritur numrin e investimeve krahasuar me atë të paraparë në fillim të vitit 2019, edhe pse si rezultat i procesit të prokurimit disa nga projektet u shtynë më tej për vitin 2020. Plani i rishikuar i investimeve për vitin 2020 parasheh



Ndërtesa e Elektrokosovës    *Elektrokosova Building*  
Bulevardi Bill Klinton nr.3    *Bill Clinton Boulevard no.3*  
Prishtinë 10000    *Prishtina 10 000*  
Republika e Kosovës    *Republic of Kosovo*



investime në vlerë rreth 30 milion euro, të cilat përfshijnë gjithashtu disa projekte nga vitet e kaluara. Megjithatë, në këtë aplikim, OSSH ka përdorur nivelin e aprovuar të investimeve gjatë periudhës së dytë rregullative, në përputhje me metodologjinë e aplikuar nga ZRRE ndër vite.

Në përputhje me aprovimet e ZRRE-së për vitin 2020 dhe konform Rregullës për Çmimet e OSSH-së, janë kalkuluar kostot e zhvlerësimit dhe kthimit për vitin përkatës t, të cilat marrin parasysh edhe përshtatjen e këtyre kostove për normën e inflacionit.





## 6. Kostot e tjera

Ky kapitull ka përmbledhur kostot që OSSH-ja do t'ia paguajë Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST), pagesën për licencë, si dhe kostot e parregulluara dhe të përjashtuara.

### 6.1. Detyrimi për Operatorin e Sistemit të Transmisionit

Me miratimin e ligjeve të reja, si dhe ndryshimet në tregun e energjisë elektrike, kostot operative të OSSH-së janë rritur, respektivisht OSSH-ja paguan Operatorin e Transmetimit për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe gjithashtu paguan edhe taksën e licencës në ZRRE.

Gjatë përcaktimit të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2019, obligimet financiare të OSSH-së të lejuara për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ishin 1.23 milion €, por detyrimet aktuale arritën në 1.45 milion €, përshtatje kjo që duhet të reflektohet gjatë përcaktimit të kostove për vitin 2020. Njëkohësisht, OSSH ka kalkuluar edhe kostot e parashikuara për vitin 2020, bazuar në tarifatat aktuale të aprovuara dhe nivelin e humbjeve të parashikuara për vitin 2020, në shumën prej 1.40 milion €. Megjithatë duhet theksuar se çdo ndryshim në tarifatat e transmetimit, duhet të pasqyrohet në llogaritjen përfundimtare kur llogariten detyrimet e OSSH-së për OST-në.

Sa i përket tarifës për licencë, megjithëse ajo nuk është pjesë e formulës sipas Rregullës së Çmimeve, tarifa për licencë është obligim i çdo të licencuari të cilën duhet ta paguaj tek Rregullatori, bazuar në përqindjen e përcaktuar dhe vëllimet e importit. Gjatë vitit 2019, OSSH ka paguar këtë taksë në shumën prej 0.07 milion €, ndërsa për vitin 2020, për shkak të volumeve më të mëdha të importit, kjo shumë parashihet të arrijë në 0.15 milion €. Duke pasur parasysh se kjo është një kosto e njohur, ne i rekomandojmë Rregullatorit që gjatë përcaktimit të kostove për vitin 2020 të marrë parasysh edhe këto shpenzime.



## 6.2. Të Hyrat e parregulluara dhe të Hyrat e përjashtuara

ZRRE për periudhën e dytë rregullative ka parashikuar 3.5 milion € të hyra të parregulluara të cilat janë përfshirë në parashikimin e MAR-it për vitin 2019, ndërsa OSSH-ja në total ka realizuar 6.8 milion euro, të cilat do të përshtaten gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara për vitin 2020, konform Rregullës për Çmime.

Sidoqoftë, në përputhje me Vendimin e ZRRE-së Nr. V\_1205\_2019 të datës 27 nëntor 2019, OSSH do të kërkojë kompensim për pagesën e konsumatorëve të cilët ishin të ngarkuar përmes Pëlqimeve Elektroenergjetike për pagesën e grupit matës, marrë parasysh se këto kosto janë zbritur nga MAR-i i vitit 2018.

Njëherazi, OSSH dëshiron të theksojë se në mënyrë që t'i ofrohet një nxitje për të zgjeruar edhe më tej shërbime të ngjashme, do të duhet të aplikohet një faktor ndarës, në të kundërtën, në formën siç aplikohet tani, OSSH-ja nuk ka ndonjë përfitim për ofrimin e shërbimeve të veçanta, nga e cila do të mund të përfitonin konsumatorët edhe më shumë.



## 7. Faktori i Rregullimit të të Ardhurave – KREV

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2019, i cili aplikohet duke llogaritur dallimin ndërmjet vlerave të parashikuara për vitin tarifor 2019 dhe atyre të realizuara.

Në këtë kuptim, OSSH ka llogaritur MAR-in aktual dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2019 dhe faktori korrigjues ka rezultuar të jetë 2.67 milion € e cila duhet të përshtatet në MAR-in e vitit 2020.

Në periudhën e kaluar rregullative, ZRRE-ja ka rritur të hyrat për total vlerën e faturuar në emër të rikthimit të humbjeve. OSSH-ja vazhdimisht e ka kundërshtuar këtë qasje duke treguar se jo e gjithë energjia e faturuar si " rikthim i humbjeve " mblidhet nga konsumatorët, për faktin se:

- Konsumatori mund të ankohet në shkallën e parë në ZRRE, dhe më vonë edhe në Gjykatë, dhe si e tillë jo e gjithë energjia e faturuar mund të lejohet të faturohet pas vendimeve të tyre, përkatësisht mbledhja e kësaj vlere është një procedurë e gjatë dhe e diskutueshme.
- Praktika tregon se vetëm një pjesë e kësaj vlere arrin të mblidhet, respektivisht rreth 20% e energjisë së faturuar në emër të Rikthimit të humbjeve.

Prandaj OSSH-ja ka aplikuar vetëm 20% të rikthimit të humbjeve dhe kërkon nga ZRRE të njohë vetëm 20% të shumës së faturuar në emër të rikthimit të humbjeve. Nëse ZRRE vazhdon të aplikojë tërë shumën e faturuar si të hyra nga rikthimi i humbjeve, atëherë OSSH-ja do të ketë nevojë për një lejim shtesë për borxhin e keq për arkëtimin që lidhet me mbledhjen e të hyrave nga rikthimi i humbjeve.



## 8. Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për vitin përkatës t

Tabela më poshtë paraqet kërkesën përmbledhëse për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2020, pas prezantimit të të gjitha komponentëve dhe kostove të arsyetuara në seksionet e mëparshme, si dhe në përputhje me shprehjen e formulës së dhënë në shtojcën 1 të Rregullës mbi Çmimet e OSSH-së:

$$\text{Mar}_t = \text{OPMC}_t + \text{DEPC}_t + \text{RTNC}_t + \text{LSSC}_t + \text{LICC}_t - \text{NTFR}_t + \text{ADJ}_t + \text{KREV}_t$$

Të Hyrat e lejuara maksimale – MAR	
OSSH	2020 (mil €)
Shpenzimet Operative	26.33
Zhvlerësimi	15.39
Kthimi	15.10
Kostot për blerjen e humbjeve	53.20
Obligimet për OST-në	1.40
Të hyrat e Parregulluara (3/5)	(3.50)
Përshtatjet per PR1 (3/5)	(1.50)
Kostot e Licencës	0.15
Faktori Korrigjues	(2.67)
<b>Kërkesa për të Hyrat e Maksimale të Lejuara</b>	<b>103.89</b>

Kërkesa e OSSH-së për të hyrat në vlerë prej € 103.89 milion është me qëllim që ajo të veprojë dhe të ofrojë shërbim sa më të mirë tek konsumatorët. Pas aprovimit nga ZRRE-ja të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2020, OSSH-ja do të përdorë MAR-in e aprovuar për të përgatitur propozimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes bazuar në metodologjinë e miratuar nga ZRRE-ja dhe rregullave në fuqi.